



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 04.07.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10 006, DATË 23.10.2008,
“PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR”, TË NDRYSHUAR”**

- **Hyrje**

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **04.07.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar*”

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit e përfaqësuar nga Znj. Ornela Çuçi, Zëvendësministre

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit**

Ky projektligj ka për qëllim të bëjë disa ndryshime e plotësime në ligjin në fuqi nr.10006/2008, të ndryshuar, për faunën e egër, në mënyrë që të adresohen ndryshimet e ndodhura si rezultat i reformës territoriale, ndryshimet në menaxhimin e pyjeve dhe organeve respektive të shërbimit pyjor në nivel vendor të vitit 2016, si dhe të reflektohet avancimi me transpozimin e dy direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës, direktivës nr.92/43/EEC “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër”, të ndryshuar, dhe të direktivës nr.2009/147/EC, “Për konservimin e shpendëve të egër”

- **Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.**

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me aktet ndërkombëtare.

- **Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së**

Ky projektligj është përafruar plotësisht me direktivën nr.92/43/EEC, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër”, të ndryshuar, nr.Celex 01992L0043-20070101, publikuar në “Fletoren zyrtare” nr.206, datë 22.7.1992, si dhe është përafruar pjesërisht me direktivën 2009/147/EC “Për konservimin e shpendëve të egër”, nr.Celex 32009L0147, publikuar në “Fletoren zyrtare” nr.20, datë 26.1.2010, faqe 7-25..

Plani Kombëtar përIntegrimin European 2018-2020

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjikë dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitulli 27: Mjedisi**” të Planit Kombëtar për Integrimin European (**PKIE**) 2019-2020.

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Neni 70 i MSA-së njih rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “*Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European*”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE): Titulli II “*Dispozita me zbatim të përgjithshëm*”, **neni 11** (ish-neni 6 TKE); Titulli XX “*Mjedisi*”, **nenet 191-193** (ish-nenet 174-176 TKE).
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Titulli VIII “*Politikat e bashkëpunimit*”, **neni 108 “Mjedisi”**.

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- **Direktiva e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 Maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”, e ndryshuar.**
Direktiva 2009/147/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 30 Nëntor 2009 “Për ruajtjen e shpendëve të egër”, e ndryshuar

Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

- **Konsultimi publik**

Në mbledhjen e Komisionit për Integrimin European nuk ka patur përfaqësues të shoqërisë civile apo të grupeve të interesit

- **Efektet financiare të aktit**

Ky projektligj nuk do të ketë efekte shtesë financiare në buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i projektligjit shoqërohet me kosto, e cila është brenda tavaneve buxhetore, të miratuara për vitin përkatës, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Gjithashtu, theksojmë se ngritja e Këshillit Kombëtar të Faunës së Egër nuk do të shoqërohet me efekte financiare.

- **Diskutimi në komision**

Nga komisioni u vlerësuan bashkëpunimi risitë e këtij projektligji.

- **Ndryshime të projektaktit (nen për nen)**

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa ndryshime si vijon:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- **Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 Maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.206, datë 22.7.1992, fq.7-50.**
- **Direktivën 2009/147/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 30 Nëntor 2009 “Për konservimin e shpendëve të egër”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32009L0147, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.20, datë 26.1.2010, fq.7-25.**

2. Në nenin 4, pika 2 të projektligjit i cili parashikon që në nenin 2 të ligjin në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër të shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, pika 2/1 që jep përkufizimin e termit “Zone” riformulohet si vijon:

“2/1. “Zonë” është një hapësirë e përcaktuar gjeografike, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi”.

3. Në nenin 4, pika 2 të projektligjit i cili parashikon që në nenin 2 të ligjin në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër të shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, pika 2/2 që jep përkufizimin e termit “Statusi i gjendjes së një lloji, ekosistemi, habitatit apo peizazhi” riformulohet si vijon:

“2/2. “Statusi i ruajtjes së një lloji, ekosistemi, habitatit **natyror** apo peizazhi” është gjendja e popullatave të llojit, ekosistemit, habitatit **nayror** ose peizazhit, që vjen nga tërësia e faktorëve që veprojnë mbi to.”.

4. Në nenin 4, pika 5 të projektligjit i cili parashikon që në nenin 2 të ligjin në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër të shtohet pika 18 që jep kuptimin e fjalës “Komisioni”, pika 18 riformulohet si vijon:

“18. “Komisioni” është Komisioni European.”

3. *KORRIGJIMI I TABELAVE TË PËRPUTHSHMËRISË QË SHOQËROJNË PROJEKTLIGJIN*

Tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë projektligjin duhet të korrigjohen nga institucioni propozues, sepse nuk janë plotësuar sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së (Neni 17, pika 2 dhe 3 të ligjit Nr.15/2015). Nga shqyrtimi dhe krahasimi i numrit dhe i tekstit të neneve të Direktivës 92/43/KEE dhe Direktivës 2009/147/KE dhe të neneve të projektligjit, të shënuara në tabelat e përputhshmërisë, me numrin dhe tekstin e neneve të projektligjit është konstatuar se tabelat e përputhshmërisë kanë pasaktësi të cilat duhet të korrigjohen:

Së pari, në tabelën e përputhshmërisë 1 që shoqëron projektligjin dhe që përmban përafrimin e neneve të projektligjit me nenet pëkatëse të Direktivës 92/43/KEE, duhet shënuar se **shkalla e përafrimit në tërësi e projektligjit me Direktivën në fjalë është e pjesshme dhe jo e plotë** siç është shënuar në tabelën që shoqëron projektligjin.

Së dyti, në tabelën e përputhshmërisë 1 që shoqëron projektligjin, titulli i Direktivës 92/43/KEE (“Direktiva 92/43/EEC ”Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës dhe faunës së egër”, amenduar. Nr.CELEX 01992L0043-20070101 publikuar në Fletoren Zyrtare Nr.206, datë 22.7.1992”) nuk është dhënë i plotë dhe i saktë . Titulli i plotë dhe i saktë i kësaj Direktive është si vijon:

“Direktiva e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 Maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.206, datë 22.7.1992, fq.7-50.”

Së treti, teksti i nenit 7 të projektligjit të shënuar në tabelën e përputhshmërisë 1 nuk i korrespondon tekstit të nenit 7 të projektligjit të propozuar, i cili është përafruar me nenin 6, të Direktivës 92/43/KEE. Për rrjedhojë teksti i nenit 7 të projektligjit të shënuar në tabelën e përputhshmërisë duhet korrigjuar.

Së katërti, në tabelën e përputhshmërisë 2 që shoqëron projektligjin dhe që përmban përafrimin e neneve të projektligjit me nenet pëkatëse të Direktivës 2009/147/KE, titulli i Direktivës 2009/147/KE (“Direktiva 2009/147/EC “Për konservimin e shpendëve të egër” Nr. Celex 32009L0147, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 20, datë 26.1.2010, faqe 7-25.”) nuk është dhënë i plotë dhe i saktë . Titulli i plotë dhe i saktë i kësaj Direktive është si vijon:

“Direktiva 2009/147/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 30 Nëntor 2009 “Për konservimin e shpendëve të egër”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32009L0147, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.20, datë 26.1.2010, fq.7-25.”

Së pesti, në tabelën e përputhshmërisë 2, në kolonat 4 dhe 5 të saj është shënuar se neni 13, pika 1 e ligjit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër është përafruar me nenin 2 të Direktivës 2009/147/KE. Në kolonat 4 dhe 5 të tabelës së përputhshmërisë shënohen vetëm nenet e projektligjit që përfaqësojnë nenet përkatëse të legjislacionit të BE-së me të cilat synohet përafrimi, dhe jo nenet e ligjit në fuqi. Komentet lidhur me shkallën e përafrimit të ligjit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër me Direktivës 2009/147/KE duhet të jepen në kolonën 7 të tabelës të titulluar “Shënime”.

Bazuar në nenin 17, pikat 3 dhe 5 të ligjit 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, sugjerojmë që KIE t’i kërkojë institucionit propozues të projektligjit:

- **korrigjimin e tabelave të përputhshmërisë, sipas vërejtjeve të lartpërmendura, dhe ridërgimin e tyre në Kuvend,**
- **reflektimin në tabelat finale të përputhshmërisë të ndryshimeve që do të pësojë projektligji gjatë shqyrtimit dhe miratimit të tij në Kuvend.**

Përfundim

- Komisioni për Integrimin Europian:
 - pasi vlerësoi qëllimin e projektligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit;
 - pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70;
 - pasi propozoi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e dispozitave dhe
 - pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe me ndryshime në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

KRYETARE

RUDINA HAJDARI